



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 37
Prishtinë, më 28.01.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica dhe Evgjëni Thaçi-Drăgusha.

Munguan: Fitore Pacolli, Sërgjan Mitroviq dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu, EUSR/EU Office; Nol Ademaj, KDI; Naim Jakaj, Kuvendi i Kosovës; Bunjamin Hoti dhe Agron Avdyli, praktikantë në GP-LDK; Blerim Sallahu, Kuvendi i Kosovës; Avni Zogiani, GP-LVV dhe media

Stafi mbështetës i komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 13, 17 dhe 19 dhjetor 2018;
3. Shqyrtimi i Draft-Planit të punës së Komisionit për vitin 2019;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2018;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Dukagjin Gorani kërkoi që në mbledhjen e ardhshme të komisionit të futet në rend dite Projektligji për dialogun, i cili është dashur të jetë pjesë edhe e kësaj mbledhjeje.

Vjosa Osmani Sadriu tha se nuk ka mundur në mënyrë unilaterale ta fusë në rend dite dhe se Projektligji për dialogun nuk i ka përmbushur afatet e parapara në rregulloren e Kuvendit. Propozoi që të kërkohet opinion nga Komisioni për Legjislacion i Kuvendit lidhur me bazën kushtetuese të këtij projektligji.

Dukagjin Gorani tha se nëse sot merremi vesh për datën e mbledhjes së ardhshme të komisionit mundemi po ashtu të merremi vesh që një procedurë e tillë të zhvillohet brenda periudhës deri te mbledhja e ardhshme.

Elmi Reçica tha se ne mundemi që brenda kësaj jave ta shqyrtojmë këtë projektligj pasi që kjo nuk është një çështje që mund të shtyhet sepse ligji ka të bëjë me dialogun me Serbinë. Ai shtoi se ne duhet ta trajtojmë, pastaj komisioni i ligjeve e ka të detyrueshëm që secilin ligj ta shqyrtojë.

Doruntinë Maloku- Kastrati propozoi që komisioni ta trajtojë në këtë mbledhje Projektligjin për dialogun, pasi që është një çështje e ngutshme.

Dukagjin Gorani, duke iu referuar propozimit të deputetes Maloku, tha se PSD-ja nuk e ka për ngut këtë ligj dhe njoftoi qëllimi i këtij ligji është që ajo që është e formuluar në rezolutën e Kuvendit për dialogun të shndërrohet në një tekst dhe në një detyrim ligjor. Shprehu mendimin se komisioni është dashur ta shqyrtojë këtë projektligj në këtë mbledhje, por meqenëse nuk ekziston komisioni në përbërje të plotë, propozoi që ky ligj të shqyrtohet në javën e ardhshme.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë të shqyrtohet në mbledhjen e radhës më 4 shkurt 2019 (e hënë).

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 13, 17 dhe 19 dhjetor 2018

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 13, 17 dhe 19 dhjetor 2018.

3. Shqyrtimi i Draft-Planit të punës së Komisionit për vitin 2019

Vjosa Osmani Sadriu kërkoi nga anëtarët e komisionit që të ofrojnë propozimet e tyre në mënyrë që të hartohet një plan pune sa më ambicioz për vitin 2019. Duke iu referuar mbledhjes së kaluar ku është diskutuar për hartimin e një plani për vizita dhe dërgimin e ftesave për komisionet homologe, kërkoi propozimet e anëtarëve për ndonjë shtet konkret për dërgimin e ftesave. Sa i përket zhvillimit të vizitave jashtë vendit njoftoi se është duke diskutuar me Ambasadën e Kosovës në Gjermani dhe në Londër, por mund të propozohen edhe vende të tjera. Ajo shtoi se gjatë këtij mandati duhet të synohet të mbulohen të gjitha shtetet e Kuintit dhe disa shtete jashtë Evropës.

Elmi Reçica propozoi që të vizitohen Gjermania, Franca dhe Holanda për shkak se lidhen me liberalizimin e vizave, dhe t'i dërgohen ftesa 5 vendeve të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën. Ai shtoi se kjo është një çështje vështirë e realizueshme, por duhet të bëhen të gjitha përpjekjet duke u koordinuar edhe me grupet e miqësisë. Reçica shprehu mendimin se nëse arrihet të sillen një përfaqësues i komisionit homolog nga këto vende mos njohëse do të ishte një avantazh për Kosovën.

Evgjeni Thaçi -Dragusha shprehu mendimin se duhet të ftohet ministrja e MIE-së për t'u informuar se cilat vende do duhej të vizitohen dhe se ku komisioni mund të japë kontributin e tij sa i përket liberalizimit të vizave. Sa i përket vizitave individuale të anëtarëve të komisionit, shprehu mendimin se në të ardhmen komisioni duhet të diskutojë paraprakisht se pse po vizitohen një vend i caktuar, pasi që nuk dihet se për çfarë arsye janë mbajtur ato takime. Lidhur me planin e punës tha se komisioni i ka formuar disa grupe punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, të cilat nuk janë aktivizuar asnjë herë dhe se nuk ka asnjë informacion për punën e tyre.

Vjosa Osmani Sadriu, sa i përket vizitave, njoftoi se në shumicën e rasteve ftesat vijnë për kryetarin e komisionit, dhe se të gjitha vizitat i ka përmbledhur në një raport të cilit e ka administratën e komisionit. Ajo po ashtu njoftoi se në mbledhjen e kaluar është kërkuar nga secili anëtarë të dorëzojë një raport të shkurtër të aktiviteteve në fushën e politikës së jashtme. Propozoi që për vizitat që zhvillohen në të ardhmen të njoftohet komisionin pas vizitës.

Elmi Reçica tha se komisionet parlamentare dhe parlamenti funksionon në bazë të marrëveshjeve dhe duhet t'i ikim orientimeve të ngushta politike. Ai më tej njoftoi se është krijuar një rregull e cila është e trashëguar se secila vizitë diskutohet në komision para dhe pas vizitës. Reçica tha se në kohën kur e ka udhëhequr këtë komision është organizuar një Samit i komisioneve parlamentare i cili ka qenë i rëndësishëm dhe me peshë të madhe.

Vjosa Osmani- Sadriu, sa i përket aktiviteteve të komisionit, njoftoi se janë mbajtur më shumë takime se komisionet e përhershme dhe se komisioni nuk mund të ketë më shumë projektligje se sa ato që i përcillen nga Kryesia e Kuvendit. Lidhur me organizimin e samitit, tha se ka diskutuar me kryetaren e Komisionit për Integritet Evropian për organizimin e një samiti të ngjashëm, duke shtuar se aspekti financiar përbën një problem. Bëri të ditur se gjatë këtij viti do të ftohen ambasadorët e Kuintit në komision për t'i diskutuar raportet bilaterale dhe pas shteteve të Kuintit do të ftohen edhe përfaqësuesit e shteteve tjera. Sa i përket planit të punës së komisionit tha për raportim u propozua të ftohet Ministria për Integritet Evropian, Ministria e Jashtme, Ministria e Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, KIESA dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Kurse sa i përket ftesave të delegacioneve u propozua të ftohen 5 vendet e BE-së jo njohëse dhe të vizitohen 3 shtete.

Glauk Konjufca kërkoi që të vazhdohet raportimi i mbetur në gjysmë nga viti i kaluar i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, i cili është zotuar se për temat e mbetura do të raportojë në komision. Shprehu mendimin se kjo është një kërkesë e arsyeshme pasi që në ndërkohë kanë dalë edhe shumë çështje tjera, sidomos sa i përket çështjes së njohjeve. Duke iu referuar një deklaratë të një ambasadorit të Kosovës në media, i cili e ka problematizuar mënyrën përmes të cilës ministri i Jashtëm i është qasur arritjes së njohjeve prej shteteve, tha se komisioni duhet t'i ketë parasysh këto pretendime dhe se duhet të kërkohen sqarime nga ministri.

Vjosa Osmani- Sadriu njoftoi se komisioni do t'i dërgojë ftesë ministrit të Jashtëm dhe të kërkojë nga ai që në periudhën e ardhshme dy javore, përkatësisht deri më 12 shkurt 2019 ta propozojë një datë për të vazhduar raportimin i cili ka mbetur në gjysmë. Osmani po ashtu njoftoi se Kryesia e Kuvendit e ka miratuar Strategjinë për bashkëpunim ndërinstitucional në fushën e politikës së jashtme përveç pikës 4.1.2.

Glauk Konjufca propozoi që të formohet një grup punues i cili në fokus i ka 5 shtetet mos njohëse të BE-së dhe i cili për së afërmi përcjell shtetet në të cilat ndryshon në mënyrë radikale pushteti politik, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën. Ai kërkoi që ky grup punues të hulumtojë dhe të krijojë një strategji përmes së cilës Komisioni për Punë të Jashtme këshillon MPJ se tanimë janë krijuar kushtet për vendosjen e relacioneve me një shtet të caktuar.

Vjosa Osmani -Sadriu tha se nëse fillohet këtë vit për ta bërë një strategji vetëm për 5 vendet mos njohëse të BE-së, atëherë kjo është e arritshme dhe se duhet të bashkëpunohet edhe me njerëz të tjerë që kanë relacione të tilla që mund ta shkrijnë kundërshtimin në raport me Kosovën.

Elmi Reçica tha se është problem që komision ta marrë gjithë atë barrë, por ia vlen të iniciohet si çështje pasi që nuk është bërë asnjë hapi tillë në këtë drejtim. Shprehu mendimin se komisioni mund të gjej mbështetje te MPJ dhe institucionet e tjera. Ai shtoi se për këtë arsye është insistuar

që të ndahet Drejtoria për Marrëdhënie Ndërkombëtare në një drejtori të veçantë dhe se është bërë gabim që nuk është përkrahur propozimi i komisionit në këtë drejtim.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Formohet grupi punues për analizimin e raporteve me 5 vendet e BE-së që nuk e njohin Kosovën, i kryesuar nga Glauk Konjufca, në të cilin grup punues ftohen për pjesëmarrje të gjithë anëtarët e komisionit.

Evgjeni Thaçi- Dragusha propozoi që te plani i punës së komisionit pika raportet e progresit të quhet raporti për vendin.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet Planin i punës së Komisionit për vitin 2019 me këto plotësime:

- *Në muajin shkurt të ftohet për raportim ministrja e MIE, znj. Dhurata Hoxha, si dhe të shqyrtohet në parim projektligji për dialogun;*
- *Në muajin mars të ftohet për raportim ministri i MPB, z. Ekrem Mustafa dhe të realizohet vizita në Gjermani;*
- *Në muajin prill të dërgohen ftesat për 5 vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën;*
- *Në muajin maj të ftohet për raportim ministri i MSH, z. Uran Ismaili;*
- *Në muajin qershor të realizohet vizita në Mbretërinë e Bashkuar;*
- *Në muajin korrik të ftohet për raportim ministri i MTI, z. Endrit Shala;*
- *Në muajin shtator të ftohet për raportim ministri i MF, z. Bedri Hamza;*
- *Në muajin tetor të ftohet për raportim i drejtorit i Agjencisë për investime dhe përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë;*
- *Në muajin nëntor të realizohet vizita në Mbretërinë e Holandës;*

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2018

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti i punës së Komisionit për vitin 2018 me plotësimet nga anëtarët lidhur me aktivitetet e tyre në fushën e politikës së jashtme.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.